



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE**  
**BALLKANIKE**



**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Letërsi e gjuhë B (4)**

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

**Viti / Semestri:** Viti III, semestri II

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e përgjithshme lëndore:** Kjo lëndë synon të informojë studentin në lidhje me zhvillimet e letërsisë turke gjatë shek. XX e në vazhdim pas shpalljes së Republikës së Turqisë në vitin 1923. Kjo periudhë karakterizohet nga zhvillimi i letërsisë turke nën ndikimin e letërsisë perëndimore. E karakterizuar me luhatje të shumta të ndikuara nga zhvillimet politike kjo periudhë paraqet ndryshimet e letërsisë turke. Rryma të reja, përplasje ideologjish politike dhe nacionaliste janë një dukuri e zakonshme e kësaj periudhe.

**Objektivat specifike lëndore:**

1. Njohuri mbi zhvillimin e letërsisë turke në shek. XX.
2. Njohuri mbi rrymat e ndryshme që lindin në Shek. XX.
3. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë së Republikës.
4. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë në vitet 1923-1945.
5. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë në vitet 1945 - 1980
6. Njohuri mbi shkrimtarët kryesorë të letërsisë nga vitet 1980 deri në ditët e sotme

**Rezultatet e pritshme:**

1. Përshkruajë dhe analizojë zhvillimet kryesore të letërsisë turke të shekullit XX e në vazhdim, në kontekstin historik, politik dhe kulturor pas shpalljes së Republikës së Turqisë.
2. Identifikojë rrymat letrare dhe drejtimet ideologjike që ndikuan në letërsinë turke gjatë periudhave të ndryshme (1923–1945, 1945–1980, pas 1980), si dhe të kuptojë karakteristikat e tyre dalluese.
3. Njohë dhe komentojë krijimtarinë e autorëve më të rëndësishëm të kësaj periudhe, duke vlerësuar kontributin e tyre në zhvillimin e letërsisë moderne turke.